



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 3, datë 10.02.2026



PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT, TË PASHPËRNDARA NË VITIN 2025, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2026

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 19.12.2025 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkinë Durrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, bashkia Durrës, në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti II – rruga ‘Miqësia’”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 30.12.2025 “Për disa shtesa në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Fondet e përfituara nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.762, datë 19.12.2025, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.767, datë 19.12.2025 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.816, datë 30.12.2025, në total me vlerë 320,423,765 lekë dhe i pashpërndarë në vitin 2025, trashëgohet në vitin 2026 dhe do të përdoret sipas tabelës së mëposhtëme:

Në lekë

Nr.	VKM që ka miratuar fondin	Emërtimi i produktit	Kodi i produktit	Kapitull	Program	Llogaria ekonomike	Fondi sipas VKM	Vlera e mbartur nga 2025
1	VKM nr. 762 dt. 19.12.2025	Rikonstruksion/riparim i banesave individuale, i mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa te njesive te banimit	94902AB	1	04960	606	169,850,000	169,850,000
2	VKM nr. 767 dt. 19.12.2025	Shpronësim për zhvillimin e njësive pas tërmetit	94902AG	1	4960	231	13,929,889	13,929,889
3	VKM nr. 816 dt. 30.12.2025	Rindertim I banesave individuale	94902AC	1	04960	606	341,609,690	136,643,876
		TOTALI						320,423,765

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Ligjore, Zyra e Posacme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 140/prot.
3

Durrës, më 16.02.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.03 datë 10.02.2026 ,” Për rialokimin e fondeve të përfituara nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit, të pashpërndara në vitin 2025, që do të trashëgohen në vitin 2026”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

